



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dostizati Primito / Pristalo Received / Delivered	23. 01. 2023	3	viti god year
Organ / Objekta Organ / Jednitsa Org / Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shtopa Prilog Appendix	Sasia Kohëzma Quantity
SKUPSHCK	676/2023		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.514/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" sipas ankesës me numër A.nr.93/2019 të datës 12.02.2019 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga Prishtina, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1, Nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundim procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.93/2019, të datës 12.02.2019, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_**

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 12.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 755/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.14-070/01-0257062/18 të datës 28.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, për shkak të shkeljeve të Ligjit për Procedurën Administrative, Ligjit për Shërbimin Civil dhe Rregullores për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, përmes shkresës me numër protokoli 2544/2021 të datës 31.05.2019, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 01.06.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1579/19 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, ndërsa Këshilli serish më datë 08.07.2021 përmes njoftimit me numër protokoli 3549/21 ka informuar ankuesin se nuk mund të vendoset për ankesën për shkak që Këshilli nuk ka kuorum, duke udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin



për Konfliktin Administrativ. Ankuesi ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative më datë 14.12.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1722/21 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi të datës 12.02.2019.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 755/2019 të datës 12.02.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për pushim e datës 15.10.2018; Akt Emërimit me Nr.01-112-639 i datës 05.09.2013; Vërtetimin 01 nr.119-112 të datës 06.09.2015; Aktvendim Cp.nr.3076/16 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ankesën e datës 24.10.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Ankesën me numër protokoll 7329/2018 të datës 04.12.2018 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.798/2018 i datës 16.01.2019 i KPMSHC; Vendimin me Nr. 14-070/01-0257062/18 të datës 28.01.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Kërkesën e datës 30.05.2019 të ankuesit; Përgjigjen në kërkesë e datës 31.05.2019 për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.1579/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Njoftimin e datës 08.07.2021 për ankuesin; Kërkesën e datës 13.07.2021 të ankuesit; Aktgjykimin A.nr.1722/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të Aktgjykimit A.nr.1722/21 të datës 14.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative si dhe pasi analizimit të shkresave e lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit me numër A.nr.93/2019 të datës 12.02.2019, *sepse:*

Nga administrimi i provave material rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Prishtinës dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit 01 nr.112-639 të datës 01.02.2017, është i emëruar në pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 2". Ankuesi më datë 15.10.2018 kishte parashtruar kërkesë për pushim vjetor për periudhën 22.10.2018 deri më datë 21.11.2018 respektivisht njëzetë e pesë (25) ditë të pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2018, mirëpo kërkesa nuk i është aprovuar nga mbikëqyrësi i tij. Kundër refuzimit të kërkesës për pushim, ankuesi më datë 24.10.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, ndërsa pas heshtjes së këtij të fundit, ankuesi me datë 04.12.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7359/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më Vendimin A.nr.798/2018 të datës 16.01.2019 ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 04.12.2018 dhe ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës që të shqyrtoj ankesën e ankuesit të datës 24.10.2018. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës duke vepruar sipas vendimit të Këshillit A.nr.798/2018, ka nxjerr Vendimin me Nr. 14-070/01-0257062/18 të datës 28.01.2021 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.



Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton së në kohën e parashtrimit të ankesës së ankuesit në Këshill ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku me nenin 39 është përcaktuar: 1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në pushim vjetor dhe në pushim për festa zyrtare në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi. 2. Gjatë çdo viti kalendarik, nëpunësi civil ka të drejtë në pushim vjetor me pagesë me kohëzgjatje minimale prej tetëmbëdhjetë (18) ditë pune, në shkallën prej një ditë e gjysmë (1.5) për çdo muaj kalendarik të punësimit. 14 3. Kohëzgjatja e pushimit vjetor do të përcaktohet në bazë të përvojës së punës dhe me këtë rast çdo dy (2) vjet përvojë pune e rrisin pushimin vjetor për një (1) ditë pune. 4. Nëpunësit civilë nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për pushim vjetor. Pushimi vjetor merret brenda vitit kalendarik që fitohet. 5. Nëpunësi civil mund t'i bartë në vitin tjetër maksimalisht dymbëdhjetë (12) ditë pune të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor duhet të shfrytëzohen brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm kalendarik....." andaj, referuar kësaj baze ligjore dhe meqenëse kanë kaluar më shumë së katër (4) vite nga koha e parashtrimit të kërkesës së ankuesit për shfrytëzimin e pushimit vjetor të vitit 2018, Kolegji i Këshillit në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vlerëson së objekti i ankesës A.nr.93/2019 të datës 12.02.2019 është bërë i pamundur për realizim në këtë fazë të vendimmarrjes, sepse ditët e pashfrytëzuar të pushimit vjetor për 2018, ankuesi ka mundur ti realizoj vetëm deri në qershor të vitit 2019 dhe atë vetëm dymbëdhjetë (12) ditë.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### Këshillë juridike:


Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.93/2019

Avdyll BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit. \_\_\_\_\_ i;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

